# DËSHMI ARKIVI

**A-474380**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Adresimi i Ramës/ Gazetari: "Lau duart" nga skandali i SHISH-it, vetë doli i ndershëm |
| ADRESA | `https://www.cna.al/politike/adresimi-i-rames-gazetari-lau-duart-nga-skandali-i-shish-it-vete-doli-i-i475347` |
| BURIMI | cna.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 27 shtator 2026, 17:03:53 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 27 shtator 2026, 16:57:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `1345e32fa648e91b868e2fef67bfb3130423b5e70abb9d568630f2d30baf532f` |
| TEKSTI | `e24259eda98def3d51681ee65f46f1bf7d2c18ca8af2f4a67802df7a697d7c81` |
| PAMJA | `6fbb53910e5bba6f90da15c0f67c2e0cb084a6ee369fef7f71337c1e22022e57` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `9f62a04e0d23abf03beb64bc917a94e8f6afbc14d66c42ccf01881d450a50671` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `622c8162b2af4b3a4f32b10517ab558346d08e6b143a7ec62e7fa674754e4065` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/9f62a04e0d23abf03beb64bc917a94e8f6afbc14d66c42ccf01881d450a50671`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

- AKTUALITET
- POLITIKË
- KRONIKA
- EKONOMI
- SOCIALE
- DENONCIM
- STIL
- SPORT
- TECH
- KULTURE
- BLOG
- LIVESTREAM

English

English

### E fundit!

x

18:57 Politikë

Gazetari Mentor Kikia ka reaguar me nota ironuzuese pas ad...

# Adresimi i Ramës/ Gazetari: "Lau duart" nga skandali i SHISH-it, vetë doli i ndershëm

27 Shtator 2026, 18:57, Politikë CNA



Gazetari Mentor Kikia ka reaguar me nota ironuzuese pas adresimit publik të kryeministrit Edi Rama.



- 

## E PLOTË/ Fjala e Ramës drejtuar shqiptarëve, nga skandali i SHISH-it te korrupsioni dhe drejtësia

Përmes një postimi në "Facebook", Kikia shprehet se me deklaratat e tij, Rama 'lan duart' nga skandali i SHISH-it.

Sipas gazetarit, Rama i la përgjegjësinë ish-drejtueses së SHISH-it, Vlora Hyseni, ndërsa nuk ngurroi të hedhë edhe akuza drejtuar Prokurorisë së Posaçme, se ka hyrë në "oborrin" e politikës.

Kikia shton se Rama sot u përbetua para shqiptarëve për ndërshëmëri, foli vetëm për veten, ndërsa të tjerët që i përkasin mazhorancës politike duhet t'ia dalin vetë.

**Reagimi i plotë:**

*Rama lan duart nga të gjithë: Unë vetë jam i ndershëm!*

*Edhe Vlora Hyseni ka vepruar me kokë të vet, për llogari të vet dhe duhet tu dalë për zot vetë akuzave. Kryministri tha se nuk dinte e as kishte pse ta dinte se çfarë mund të ketë bërë shefja e SHISH.*

*Megjithatë ai e akuzoi SPAK-un se "ka hyrë në oborrin e politikës" e po bën politikë me dosje.*

*Ndërsa më pas u krenua për ngritjen e SPAKU-ut që po lufton korrupsionin.*

*Por, ajo që dalloi në këtë "mesazh për popullin", ishte përbetimi për ndershmërinë e tij. Ishte një distancim i hapur nga qeveria dhe mazhoranca politike, ata që janë në burg, ata që janë në gjyq, ata që janë nën hetim e ata që mund të vihen nën hetim në të ardhmen.*

*Sot Rama foli vetëm për Edin!*

*Ai përsëriti shprehjen se "nuk ka bir nëne të gjejë një qindarkë të vetme nga paratë e tij në xhepin tim dhe familjes time", dhe se askush në këtë vend nuk ka fituar një lek në mënyrë të pa ligjshme, me një firmë të hedhur prej tij.(Kjo ndoshta ngaqë Rama s'para firmos vetë).*

*Ai nuk tha se nuk ka para të vjedhura në xhepat e ministrave dhe drejtorëve, apo me firmat e ministrave dhe drejtorëve, por "në xhepat e mi dhe me firmën time".*

*Ai sot tha vetëm "Unë, unë, unë, unë".*

*"Unë e bëra drejtësinë; unë ia dhash shpatën që po pret koka; unë luftoj korrupsionin; unë do e çoj vendin në BE; unë e dua këtë vend; unë e dua flamurin kuq e zi; unë do të bëj histori dhe jo pasuri".*

*Gjatë këtyre ditëve të "romancës" Gysi-Vlora, të cilën ai e ndoqi nga Nju Jorku, mesaduket Rama ka kuptuar se e vetmja gjë që mund dhe duhet shpëtuar tani është ai vetë, si mundësia e vetme për të vazhduar qeverisjen.*

*Rama sot iu drejtua popullit, për të thënë se tashmë duhet të kenë besim vetëm tek ai. Vetëm tek ai të kenë shpresë.*

*Të tjerët, ata që kanë hedhur firma apo kanë bërë "plaçkë", të bëjnë ç'të munden, ti dalin vetes për zot, për çfarë ka dalë në dritë deri sot, e mbi të gjitha, për çfarë mund të dalë në të ardhmen.***/CNA**








## Të sugjeruara

**“Bashkia Tiranë, totalisht e bllokuar”/ Alimehmeti: Telenovelë e Veliajt në kurriz të qytetarëv**

**Noka sulmon Ramën: I ka hyrë lepuri në bark, strumbullar i skandaleve shtetërore**

**Berisha udhëton në Strasburg/ Zbardhet agjenda e kryedemokratit**

**“Do të mbajë pushtetin me forcë”/ Këlliçi reagon për adresimin e Ramës**

**E PLOTË/ Fjala e Ramës drejtuar shqiptarëve, nga skandali i SHISH-it te korrupsioni dhe drejtësia**

**Konferenca e Ramës/ PD: Shmangie e llogaridhënies, komunikim i kontrolluar**

**“Askush nuk mund të më ndalë”/ Rama, drejtuar shqiptarëve: Korrupsioni, hije e rrezikshme e rrugës sonë**

**Rama përsërit refrenin: Kush i hap llogari vetes me drejtësinë është çështje individuale**

**Këlliçi, akuza Ramës pas fjalimit në OKB: Përdore antisemitizmin për të mbuluar skandalet e narkoshtetit**

**Konferencë e pazakontë/ Rama u drejtohet nesër shqiptarëve**

**Protestuesit i gjuajtën me vezë/ Rama, me batuta: U ndjeva mirë, Pjerin Ndreu erdhi me vrap**

**Rama me shqiptarët në New York: Diaspora ka hyrë në fazë të re, jo vetëm solidaritet**

Shqipëria me Institut për të Miturit që kryejnë krime, ja kur do të jetë gati

PROFIL-Nga karriera si ushtarak, te politika/ Kush është Eric Wendt, ambasadori i ri i SHBA-së në Shqipëri

PD, letër zyrtare Peleshit: Të ngrihet Komision Hetimor për zgjedhjet e 11 majit

Takimi në Presidencë/ Zbardhen diskutimet e ambasadorit të ri të SHBA-së me Begajn

3 shqiptarë humbën jetën nga tragjedia në Athinë/ Deputeti: Ministria dhe Ambasada, asnjë reagim

Ministri Demo viziton Kombinatin: Nis rindërtimi për banesat e reja, pasojë nga tërmeti i 2019-ës

Fjalimi i Ramës në OKB/ Berisha: Salla bosh, bojkot Padrinos

"Ripërtëritja e PD-së, jetike për vendin"/ Berisha: Situata aktuale kërkon ndërhyrje të menjëhershme

## editorial

09:11 Editorial Bujar Leskaj

**Të ndihmojmë SHISH-in të mbrojë shtetin nga krimi, dhe jo krimin nga shteti!!**

**CNA LIVESTREAM**

Na ndiqni edhe në

## acromax

19:53 Acromax / Aldor Nini

**Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH**

opinion

07:33 Opinione Sadik Bejko

**Rasputin, patronazhizmi seksual**

21:28 Opinione Erion Dasho

**SI PRODHOHET NJË KONSPIRACION?**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.